

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MIKAIL LILE
NOTER NE PERMET



NR 4332 REPERTORI
NR 824 KOLEKSIONI

KONTRATE SHITBLERJE
(per shitje te kuotave te kapitalit tek te tretet)

Sot date 16.09.2006 , gjashtembedhjete Shtator dy mije e gjashte , ne Permet, ne zyren time noteriale , prona ime, te ndodhur prane Gjykates se rrethit Permet , para meje noterit Mikail Lile u paraqiten personalisht palet kontraktues:

SHITESIT :Gjergji Petro , i biri i Leonidhes, i datelindjes 1967, lindur ne Permet, banues ne Tirane, rruga " Komuna e Parisit " , madhor , me zotesi te plote per te vepruar, i njohur prej meje noterit .

BLERESIA ; Yllka Proko , bija e Musait, e datelindjes 27 prill 1971 , lindur ne Korçe, banuese ne Permet, madhore, me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar prej pasaportes se saj me nr Z1149574.

OBJEKTI ; I shitet pales blerese 100 % (njeqind perqind) e kuotave te kapitalit te shoqerise tregtare " TV – PERMET " sh.p.k. regjistruar me vendimin e gjykates Tirane me nr 36135 date 11.07.2006 , me ortak te vetem dhe administrator Gjergji Petro , me seli ne Lagjen e Re , Nr. 10 ne qytetin e Permetit . I shitet blereses kundrejt çmimit te shitblerjes prej 100.000 (njeqind mije) leke .

. Shitja behet ne baze te Ligjit Nr. 7638 date 19/11/1992 " Per shoqerite tregtare " , neni 47 , Trasferimi te te tretet , statutit dhe aktit te themelimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "TV – PERMET " sh.p.k. .

Shitesi Gjergji Petro ne baze te vendimit te gjykates Tirane me nr 36135 date 11.07.2006 eshte ortak i vetem dhe administrator i shoqerise " TV – PERMET "sh.p.k.. me seli ne Lagjen e Re , Nr. 10 , Permet, me kapital themeltar 100 % prona e tij e barabarte kjo me shumen 100.000 (njeqind mije) leke.Objekti I veprimtarise se shoqerise ne fjale eshte ajo radiotelevizive qe perfshin prodhimin , trasmetimin dhe ritrasmetimin e programeve dhe informacioneve te çdo lloj me ane te zerit , figures , sinjaleve te koduara , shkrimit te destinuar per publikun nepermjet valeve elektromagnetike , kabllave perseritesve , sateliteve apo me çdo mjet tjetër .


Shitesi Gjergji Petro deklaroi se me vullnet te lire I shes blereses Yllka Proko 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise si me siper kundrejt çmimit te shitblerjes prej 100.000 (njeqind mije) leke . shume e cila sipas deklarimit te paleve eshte paguar paraprakisht nga pala blerese dhe eshte mare teresisht prej pales shiteses jashte kesaj zyre noterie dhe para redaktimit te kesaj kontrate shitblerje .

Une noteri sqaroj palet per pasojat juridike te tyre, te drejtat dhe detyrimet ne baze te Kodit Civil, palet deklaruan se I kuptojme ato.

Pala shiteses deklaroi se pranoj humbjen e pronesise mbasi ajo fitohet prej pales blerese e cila behet pronare me te gjitha te drejtat dhe detyrimet e shoqerise tregtare " TV - PERMET " sh.p.k.

U sqaruan palet per domosdoshmerine e regjistrimit te kesaj kontrate ne regjistrin tregetar te shoqerise prane Gjykates Tirane, palet deklaruan se e kuptojme ate.

Une noteri mbasi konstatoj vullnetin e lire te paleve, fakti qe transferimi i kuotave te kapitalit te ortakut te vetem gjen sanksionim ne nenin 47 te Ligjit me nr. 7638 date 19.11.1992 " per shoqerite tregetare " dhe nuk vjen ne kundershtrim me Statutin dhe Aktin e themelimit te shoqerise " TV - PERMET " sh.p.k. vertetuar ne noterine Tirane me nr 2836 repertori, nr. 1795 koleksioni date 05.07.2006, mbasi akti kerkohet me ze, nenshkruhet regullisht dhe legalizohet edhe prej meje noterit qe redaktoj dhe legalizoj kete kontrate shitblerje me objekt transferitim i kuotave te kapitalit te shoqerise " TV - PERMETI " sh.p.k. .



Pulla takse ne kopjen e pare .

SHITESI

[Handwritten signature]

BLERESI

[Handwritten signature]

NOTERI
Mikail Lile

[Handwritten signature of Mikail Lile]

